



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 120/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.03.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Start 2000” shpk, në procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr. Ref-39584-12-28-2017, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të ambjenteve të DRFSDKSH-së Tiranë për vitin 2018”, me fond limit 2.916.060,36 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 08.01.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e FSDKSH-së Tiranë. Gjithashtu ngrihen pretendime për ofertues të tjerë pjesëmarrës në procedurë.

Ankimues:

“Start 2000” sh.p.k
Rruga Budi, Nr.19,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria Rajonale e FSDKSH-së Tiranë
Rruga “ Him Kollit”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 29.12.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Marrëveshje kuadër*” me Nr. Ref-39584-12-28-2017, me objekt: “*Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të ambjenteve të DRFSDKSH-së Tiranë për vitin 2018*”, me fond limit 2.916.060,36 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 08.01.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e FSDKSH-së Tiranë.

II.2. Në 23.01.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Sipas informacionit të autoritetit kontraktor rezulton si më poshtë vijon:

1. “Toni Security” sh.p.k	5.791,00 lekë, skualifikuar
2. “Myrto Security” sh.p.k	6.017,57 lekë, skualifikuar
3. “Ballazhi” sh.p.k	6.463,56 lekë, skualifikuar
4. “Pelikani Security Group” sh.p.k	6.730,08 lekë, skualifikuar
5. “Snajper Security” sh.p.k	6.904,84 lekë, skualifikuar

6. “Trezhnjeva” sh.p.k	6.904,84 lekë, skualifikuar
7. “A-2000” sh.p.k	6.904,84 lekë, skualifikuar
8. “Safe” sh.p.k	6.904,84 lekë, skualifikuar
9. “Oktapus 1 Security” sh.p.k	6.905,10 lekë, skualifikuar
10. “Anakonda Security” sh.p.k	6.905,19 lekë, skualifikuar
11. “SSX” sh.p.k	6.905,19 lekë, skualifikuar
12. “International Security Albania” sh.p.k	6.905,19 lekë, skualifikuar
13. “Dea Security” sh.p.k	6.905,71 lekë, skualifikuar
14. “Conspiracion Metropol” sh.p.k	7.414,28 lekë, skualifikuar
15. “Eurogjici Security” sh.p.k	7.977,00 lekë, skualifikuar
16. “Start 2000” sh.p.k	7.987,96 lekë, skualifikuar
17. “Nazeri 2000” sh.p.k	7.988,31 lekë, kualifikuar
18. “Arbana Sh.A” sh.p.k	7.988,33 lekë, kualifikuar
19. “Leksi Security” sh.p.k	7.988,33 lekë, kualifikuar
20. “Ales” sh.p.k	7.988,33 lekë, kualifikuar
21. “Aulona Pol 1” sh.p.k	7.988,33 lekë, kualifikuar
22. “Oktapus” sh.p.k	7.990,45 lekë, skualifikuar
23. “GSE Security” sh.p.k	1.172,30 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 23.01.2018 operatori ekonomik ankimes “Start 2000” shpk, është njoftuar elektronikisht mbi skualifikimin e tij me arsyen se:

“Refuzoi kërkesën nga autoriteti kontraktor për gabimet aritmetike, në vlerën jo më shumë se +/- 2% të ofertës së ofruar, referuar nenit 66, pika 4 të VKM nr.914, dt.29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

II.4. Në datën 25.01.2018 operatori ekonomik ankimes “Start 2000” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“Autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e FSDKSH-së Tiranë, me datë 08.01.2018 zhvilloi procedurën e tenderimit me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të Drejtorisë Rajonale të FSDKSH-së Tiranë për vitin 2018”, me fond limit 2.916.060,36 lekë pa tvsh. Operatori ynë paraqiti ofertën prej 7987,96 lekë pa TVSH.

1. Në datën 19.01.2018 autoriteti kontraktor dërgon mesazh me këtë përmbajtje:

“Lënda: Kërkesë për pranim të korigjimit të ofertës

Drejtuar: ShPSF “Start 2000”

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Bazuar në formularin tuaj të ofertës, në procedurën e prokurimit publik “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike të ambienteve të DRFSDKSH-Tiranë për vitin 2018, oferta juaj është: 7.987,96 lekë pa tvsh për njësi/ditë dhe 2.915.926,44 lekë pa tvsh për 12 muaj.

Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezultoi se oferta juaj ka gabime aritmetike.

Analiza e saktë e koston sipas legjislacionit në fuqi do të jetë si më poshtë:

Paga bazë: 36.000 lekë; Shtesa për turnin e II: $3 \text{ orë} \times 206,89 \text{ lekë} \times 20\% \times 30,42 \text{ ditë} = 4,98 = 758,26 \text{ lekë}$;
Shtesa për turnin e III: $8 \text{ orë} \times 206,89 \text{ lekë} \times 50\% \times 30,42 \text{ ditë} = 4,98 = 5.055,1 \text{ lekë}$.

Paga+Shtesa turni II+Shtesa turni III = 41.813,36 lekë.

Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 16,7%: $41.813,36 \text{ lekë} \times 16,7\% = 6.982,83 \text{ lekë}$.

Totali i shpenzimeve për një roje në muaj: $41.813,36 + 6.982,19 = 48.796,19 \text{ lekë}$.

Totali i shpenzimeve për 4,98 roje në muaj: $48.796,19 \text{ lekë} \times 4,98 = 243.005,03 \text{ lekë pa tvsh}$.

Kosto ditore për një vendroje me tre turne (me koeficient zëvendësimi 1,66 roje për turn):
 $243.005,03 : 30,42 \text{ ditë} = 7.988,33 \text{ lekë pa tvsh}$.

Bazuar në nenin 66, pika 4 e VKM-së nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ju dërgojmë këtë kërkesë për pranimin e gabimeve aritmetike.

Lutemi na vini në dijeni brenda afatit 3 ditor (ditë kalendarike) nga marrja e kësaj kërkesë për pranimin ose refuzimin e gabimeve në llogaritje.

Oferta e saktë është 7.988,33 lekë pa tvsh.”

Në datën 19.01.2018 operatori ynë ekonomik ka kthyer përgjigje me këtë përmbajtje:

“Faleminderit, por operatori ynë i qëndron analizës në DT, duke argumentuar se pjestimi për të nxjerrë mesataren mujore pra; 365 ditë me 12 muaj është 30,41 dhe jo 30,42. Për cdo rast kjo është marrë si mesatare (shih vendimin KPP 591/2017 si dhe rekomandimet e APP e KPP).”

2. Në datën 22.01.2018 AK dërgon mesazh me këtë përmbajtje:

“Kthim përgjigje

Lutemi na bëni me dije për përgjigjen tuaj brenda datës 23.01.2018.

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: ShPSF “Start 2000”

Ju sqarojmë se gabimet aritmetike të konstatuara në ofertën tuaj janë si më poshtë:

Sipas analizës suaj të kostos, cmimi i llogaritur për një vendroje me tre turne, me 4,98 roje për 1 muaj është: $48.793,95 \times 4,98 \text{ roje} = 242.993,87 \text{ lekë pa tvsh/1 muaj}$.

Deri në këtë moment nuk ka asnjë gabim në llogaritje, cdo gjë është e argumentuar dhe ju i jeni referuar llogaritjes mesatare mujore 30,41 ditë. Por cmimi për 1 vendroje me tre turne për 1 ditë (të cilën ju nuk e keni pasqyruar në llogaritje por keni nxjerrë një rezultat të paargumentuar prej 7.987,96 lekë), sipas analizës sonë del:

$242.993,87 : 30,41 \text{ ditë} = 7.990,59 \text{ lekë pa tvsh/1 ditë}$.

Nëse rezultati përfundimtar që ju keni nxjerrë ka qënë $242.993,87 \text{ lekë} : 30,42 = 7.987,96 \text{ lekë}$, kjo tregon se ju nuk i keni qëndruar të njëjtit kriter të mesatares me 30,41 ditë gjatë gjithë analizës së kostos por keni përdorur kriteret e ndryshme për të nxjerrë një rezultat më të ulët.

Lutemi na bëni me dije nëse pranoni korrigjimin e ofertës. Në të kundërt, bazuar në VKM nr. 914, neni 66/4, oferta juaj do të refuzohet.”

Në datën 23.01.2018, para orës 12.00 paradite, operatori ynë ekonomik ka kthyer përgjigje me këtë përmbajtje:

“Po, jemi dakort me korrigjimin tuaj dhe në vijim të veprimeve, shuma do të jetë **7.990,59 lekë** në ditë pa tvsh” dhe bashkëlidhur kemi dërguar analizën e cmimit.

Në datën 23.01.2018, ora 16.30 (KVO) ka bërë vlerësimin e ofertave, duke mos e pranuar ofertën tonë ekonomike, me pretendimin se: “Refuzoi kërkesën e AK për gabimet aritmetike në vlerën jo më shumë +/- 2 të ofertës së ofruar.”

Operatori ynë ekonomik gjykon se:

AK ka dy llogaritje të adresuara operatorit tonë ekonomik:

1.

Në mesazhin e parë, llogaritja e shtesave të turneve është bërë mbi bazën e ditëve mesatare vjetore 30,42 ditë. Oferta e saktë, sipas AK ishte 7.988,33 lekë pa tvsh, dhe ku paga për një vendroje në muaj ishte 243.005,03 lekë dhe për një roje ishte 48.796,19 lekë. Përfundimisht sipas analizës së kostos të bërë nga AK duhet të ishte 7.988,33 lekë pa tvsh.

Nisur nga sa më sipër, operatori ynë ekonomik ktheu përgjigje:

Faleminderit, por operatori ynë i qëndron analizës në DT, duke argumentuar se pjestimi për të nxjerrë mesataren mujore pra 365 ditë me 12 muaj është 30,41 dhe jo 30,42 [...].

2.

Në mesazhin e dytë na sugjerohet se deri në këtë moment nuk ka asnjë gabim në llogaritje, cdo gjë është e argumentuar dhe ju i jeni referuar llogaritjes me mesataren mujore 30,41 ditë.

$48.793,95 \times 4,98 \text{ roje} = 242.993,87 \text{ lekë pa tvsh/1muaj.}$

Nëse rezultati përfundimtar që ju keni nxjerrë ka qënë $242.993,87 : 30,42 = 7.987,96 \text{ lekë}$

Operatori ynë ekonomik vëren se mesazhet në përmbajtje për pagat për një roje dhe 1 vendroje kanë vlera të ndryshme.

E para është 243.005,03 lekë në muaj për 1 v/r dhe për një roje ishte 48.796,19 lekë.

E dyta është 242.993,87 lekë pa tvsh/1 muaj dhe për një roje është 48.793,95 lekë.

Në llogartijen e dytë AK e ka cilësuar të saktë dhe të njëjtë me llogaritjen e operatorit tonë ekonomik dhe si e tillë është dysheme vlerësimi për të gjithë operatorët. Kjo shumë duhej të pjestohej me 30,41 ditë dhe në asnjë rast nuk do të kishte vlerë tjetër përveç 7.990,59 lekë.

Sipas kërkesës së mesazhit të dytë dërguar nga AK me datë 22.01.2018, kërkonim pranim për korrigjim oferte brenda datës 23.01.2018.

Operatori ynë ekonomik pranoi gabimin e bërë për pjestimin e bërë me 30,42 ditë dhe dërgoi ofertën e re të shoqëruar me analizë cmimi para orës 12.00 paradite, por cuditërisht në orën 16.30, datë 23.01.2018 AK në faqen elektronike shpalli vlerësimin e ofertave, duke refuzuar ofertën tonë.

Ne pyesim se cilit operator të pranuar nga ju, vlerën prej 242.993,87 lekë pa tvsh/1 muaj për 1 v/r (të saktë) ka pjestuar me 30,41 ditë mesatare mujore dhe vlera që del është vlerë tjetër dhe jo 7.990,59 lekë.

Operatori ynë gjykon se vlera prej 7.990,59 lekë është e vetmja vlerë ligjore e ofertës dhe se AK nuk duhet të kishte pranuar ofertat me vlerë 7.988,31 lekë, 7.988,33 lekë [...].

Kërkojmë:

1. Të pezullohet kjo procedurë tenderimi.
2. Skualifikimin e ofertve të operatorëve ekonomikë “Nazeri 2000” sh.p.k, “Ales” sh.p.k, “Leksi Security” sh.p.k, “Arbana Sh.A” sh.p.k dhe “Aulona Pol 1” sh.p.k si oferta me vlerë të llogaritura gabim dhe jo ligjore.
3. Kualifikimin e ofertës sonë ekonomike.”

II.5. Në datën 02.02.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit nëpërmjet shkresës nr 1854/1 prot., datë 31.01.2018, duke e refuzuar ankesën.

II.6. Në datën 08.02.2018 operatori ekonomik “Start 2000” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 01.03.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 203/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1278/3 prot., datë 01.03.2018 me objekt: “Dërgim informacioni”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës. Sipas autoritetit kontraktor “[...] në datën 19.01.2018 KVO-ja me shumicë votash (2:1) ka kërkuar elektronikisht me mesazhe për korigjim aritmetik, këtyre operatorëve: Ales, Aulona Pol 1, Eurogjici Security, Leksi Security, Nazeri 2000 dhe Start 2000. U përgjigjën elektronikisht Ales, Aulona Pol 1, Eurogjici Security, Leksi Security, Nazeri 2000 dhe Start 2000.

Në datën 23.01.2018 nga KVO me shumicë votash (2:1) u kualifikuan këta operatorë ekonomikë: “Nazeri 2000” sh.p.k, me ofertë ekonomike në vlerën 7.988,31 lekë; “Ales” sh.p.k, me ofertë ekonomike në vlerën 7.988,33 lekë; “Leksi Security” sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 7.988,33 lekë; “Arbana ShA” sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 7.988,33 lekë; “Aulona Pol 1” sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 7.988,33 lekë [...] dhe skualifikuan ofertuesit e tjerë. [...] Operatori ekonomik “Start 2000” sh.p.k është skualifikuar se nuk ka pranuar korigjimin aritmetik.”



pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k se: “[...] jemi dakort me korigjimin tuaj (AK-së) dhe në vijim të veprimeve, shuma do të jetë **7.990,59 lekë** në ditë pa tvsh [...]” e për pasojë “kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë ekonomike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në njoftimin e kontratës, pika 2.2 e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, është parashikuar si më poshtë vijon:

”Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. *Fondi i Marrëveshjes Kuadër për 12 muaj- 2,916,060.36 (dy milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë e gjashtëdhjetë pikë tridhjetë e gjashtë) LEKE PA TVSH*
2. *Fondi limit për një vëndroje/DITORE 7,988.33 (shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) LEKE*

3. *Burimi i Financimit : DRFSDKSH Tiranë*

4. *Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër : “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të ambjentëve të DRFSDKSH-së Tiranë për vitin 2018” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.»*

III.1.2. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës”, pjesë e dokumentave të tenderit, është kërkuar përgatitja e ofertës ekonomike si më poshtë:

1	2	3		4	5
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi /dite	Afati i perlllogarit ur ne dite
1.	Shërbimi i ruajtjes se godines se _____ per 1 vend roje me 3 turne	dite	1		
	Çmimi Neto				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Sqarime:

1. *Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per shërbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.*
2. *Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.*

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperem, duke pasqyruar te gjitha koston per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399, datë 3.5.2017,” Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Ligji Nr. 7961, datë*

12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

III.1.3. Në shtojcën 6, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 7, është kërkuar si më poshtë:

“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur. (Shih Shtojca I - Sqarime).”

III.1.4. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Start 2000” sh.p.k në procedurën e mësipëme të prokurimit, rezulton se formulari i ofertës përmban cmimin për njësi/ditë në vlerën 7.987,96 lekë. Bashkëngjitur formularit të ofertës është analiza e cmimit dhe preventivi më të njëjtën vlerë.

III.1.5. Referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, kryesisht nga materialet dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria “Start 2000” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, në përgjigje të kërkesës së dytë të autoritetit kontraktor, drejtuar ankimuesit, për korrigjimin e ofertës ekonomike, si rezultat i gabimeve të konstatuara në përlllogaritjen e saj, pala ankimuese pranon gabimin e bërë, duke e saktësuar vlerën për 1 vendroje në ditë nga 7.987,96 lekë në 7.990,59 lekë pa tvsh.

III.1.6. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik, duke pranuar korrigjimin e ofertës së tij ekonomike për 1 vendroje në ditë nga 7.987,96 lekë në 7.990,59 lekë pa tvsh, ka tejkaluar fondin limit të parashikuar nga autoriteti kontraktor për realizimin e kontratës për një vendroje në ditë e për pasojë edhe fondin limit të parashikuar për realizimin në tërësi të objektit të prokurimit për 12 muaj në një vendroje me tre turne dhe 4.98 roje për vendroje, sikurse është përcaktuar në objektin e prokurimit të njoftimit të kontratës si më sipër cituar, duke bërë të

pavlefshme ofertën e operatorit ekonomik « Start 2000 » sh.p.k. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, pasi në rast se nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta do të refuzohen si të papranueshme, sikurse është parashikuar në pikën II, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1, të Dokumentave standarte të Tenderit. Operatori ekonomik ankimues pohon se oferta e tij reale është 7.990,59 lekë për një vendroje në ditë, ndërkohë që autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës ka parashikuar fondin limit për një vendroje/ditore në vlerën 7,988.33, ofertë e cila i tejkalon mundësitë dhe kapacitetet monetare të parashikuara për këtë prokurim, jo vetëm për një vendroje në ditë por edhe për realizimin e shërbimit të ruajtjes me roje të objektit në fjalë për gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit.

Përsa më sipër cituar, kërkesa e operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k për kualifikimin e ofertës së tij ekonomike, nuk pranohet.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomikë ankimues “Start 2000” shpk për kualifikimin e padrejtë të ofertuesve të tjerë, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se:

III.2.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “Start 2000” sh.p.k. mbetet i skualifikuar në bazë të arsytimit të KPP-së, pra trajtimi i pretendimit të tij në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar pretendimi mbi skualifikimin e tij të padrejtë. Rrjedhimisht, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë

e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, ndaj dhe ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim.

Për rrjedhojë, këto pretendime nuk merret në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr. Ref-39584-12-28-2017, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të ambjentëve të DRFSDKSH-së Tiranë për vitin 2018”, me fond limit 2.916.060,36 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 08.01.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e FSDKSH-së Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të pasqyrojë në SPE skualifikimin e shoqërisë “Start 2000” sh.p.k për tejkallim të fondit limit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 203 Protokolli;

Datë 08.02.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha